




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Datë: 17.05.2024

Mbledhja e 205 e Qeverisë e Republikës së Kosovës mbahet më 21.05.2024, në orën 10:00, ndërtesa e Qeverisë, sala P-31.

RENDI I DITËS

1. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për aprovimin e ekstrakteve të procesverbaleve dhe transkriptet nga mbledhjet: 198 dhe 200 dhe ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhjet: 197, 199 dhe 201 elektronike/korresponduese të Qeverisë së Republikës së Kosovës (ZKM)
2. Shqyrtimi i Nismës për lidhjen e Marrëveshjes për Sigurime Sociale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë (MFPT)
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Amendamentimit Nr. 2 të Marrëveshjes Financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Programin IPA 2016 (ZKM)
4. Shqyrtimi i Projekt-rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës (ZKM)
5. Shqyrtimi i Draftit të Raportit për Vlerësimin *Ex-Post* të Ligjit për Kundërvajtje (ZKM)
6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për rialokimin e mjeteve buxhetore në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal (MZHR)
7. Shqyrtimi i Kërkesës së Ministrisë për Komunitete dhe Kthim për ndarje të mjeteve buxhetore për realizimin e projektit përmes marrëveshjeve me trupat e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (MFPT)
8. Shqyrtimi i Kërkesës së Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për ndarje të mjeteve buxhetore për realizimin e projektit përmes marrëveshjeve me trupat e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (MFPT)
9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndarjen e mjeteve buxhetore për "The Kosovo American Education Fund", me qëllim të promovimit të vendit (ZKM)
10. Shqyrtimi i Propozim-vendimit Preliminar për shpronësim për interes publik të pronës së paluajtshme e cila preket nga realizimi i Projektit: "Ndërtimi i Qendrës së Paraburgimit dhe Institucionit Korrektues në Prizren" (MMPHI)

11. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shqyrtimin e mëtejme të kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme të cilat preken nga realizimi i Projektit: "Ndërtimi i Rrugës Rajonale R221 Cerkoz - Rakosh" (MMPHI)
12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shqyrtimin e mëtejme të kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme të cilat preken nga realizimi i Projektit: Konservimi, Restaurimi dhe Ndërtimi i Kompleksit Memorial "Masakra e Reçakut" (MMPHI)
13. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shpërbërjen vullnetare të Ndërmarrjes Publike Qendrore "Ndërmarrja e Re Energjetike e Kosovës (NKEC) (ME)
14. Shqyrtimi i Draftit të Raportit Vjetor të Performancës për Ndërmarrjet Publike për vitin 2022 (ME)
15. Shqyrtimi i Draftit të Planit për Menaxhimin e Pellgut Lumor Drini i Bardhë (MMPHI)
16. Të ndryshme